REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr.787/8 Prot.

Sarandë, më 03.02.2026

PROÇESVERBAL

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Sarandë që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 13:00
Data e mbajtjes së mbledhjes :29.01.2026
Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak
Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Sarandë: Kryetar i Bashkisë Z.Oltion Çaçi dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen.

Marrin pjesë :

1. Asaf Stroka
2. Gjergji Imeraj
3. Festim Mina
4. Zana Piro
5. Vesel Koçiu
6. Përparim Ahmeti
7. Bejdo Çela
8. Anjeza Dike
9. Dafina Allkushi
10. Elona Mano
11. Ermir Hoxha
12. Klejdjan Murtaj
13. Kevin Alikaj
14. Ibrahim Bajrami
15. Ilirjan Gërdhuqi
16. Enea Vasili
17. Katerina Beqo
18. Pranvera Osmani

Mungojnë :

19. Angjele Lapa
20. Shpëtim Ahmeti
21. Laureta Çeçi
22. Dritan Peçi
23. Denisa Islamaj
24. Ilva Qëndro
25. Eugen Qëndro
26. Farie Hyska
27. Indi Rrapaj
28. Lindita Kondi
29. Xhino Jaçaj
30. Thanas Gurma

Asaf Stroka : Përshëndetje !
Të nderuar Anëtarë të Këshillit Bashkiak! I nderuar Zv/Kryetar i Bashkisë!Të nderuar pjesëmarrës dhe përfaqësues të medias !
Zhvillojmë mbedhjen e Këshillit Bashkiak datë 29.01.2026, vijojmë bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, çdo fillim mbledhje miratohet rendi i ditës sipas thirrjes për zhvillimin e mbledhjes sipas rendit si më poshtë:

1. **P/vendim** "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin Dhjetor 2025".

2. **P/vendim** "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Dhjetor 2025".

3. **P/vendim**"Për miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si dhe nga fondet e buxhetit vendor për vitin 2026".

4. **P/vendim**"Për miratimin e listës së përfituesve nga programi subvencionimit të qirasë në tregun e lirë .

5. **P/vendim**"Për miratimin e listës emërore të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike që do të përfitojnë bursat financiare për vitin shkollor 2025-2026".

6. **P/vendim** "Për miratimin e përdorimit dhe planin të shpërndarjes së fondit të grantit të bazuar në performancë të bashkive për vitin 2025 "

7. **P/vendim** "Për miratimin e një ndryshimi në fushën e përdorimit të pasurisë 15/609 me sipërfaqe 9200 m^2 dhe pasurisë 15/610 me sipërfaqe 10810 m^2 zona kadastrale 8642 "truall" në pronësi të Bashkisë Sarandë , duke shtuar fushën e përdorimit për zhvillimin e programeve të arsimit parauniveristar dhe zhvillimin e projektit "poli i zhvillimit turistik sarandë".

8. Raport mbi veprimtarinë e Këshillit të Bashkisë për vitin 2025.

Ibrahim Bajrami : A mundemi që ta vendosim në rendin e ditës në pikën 8, dhe pikën 8 ta kalojmë në pikën 9,Informacion mbi transferimin e komunitetit romë nga ambjentet e ish kinemasë së Çukës?

Asaf Stroka: Hedhim në votim rendin e ditës me propozimin e bërë nga z.Bajrami.

Miratohet me 18 vota pro rendi i ditës .

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e parë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin dhjetor 2025".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 1 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 18 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: **P/vendim** "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin dhjetor 2025".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 2 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 18 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e tretë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si dhe nga fondet e buxhetit vendor për vitin 2026".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 3 të rendit të ditës, kemi ndonjë pyetje nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 18 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e katërt të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin e listës së përfituesve nga programi subvencionimit të qirasë në tregun e lirë .

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 4 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Gjergji Imeraj: Drejtorisë përkatëse për të bërë një sqarim që të gjithë procedurën përfituesit mënyrën dhe që është pra të siguroj që të vihen në dijeni edhe qytetarët të tjerë që mund ta përfitojnë, por nuk kanë dijeni. çfarë është ky program për qytetarët dhe sa kanë përfituar te ky rast

Anila Pikuli: Edhe siç kemi vënë në dijeni, në momentin kur ne aprovuam kuotat për qirat pra për investimin e qirasë në tregun e lirë dhe në momentin që u aprovuan në Këshillin Bashkiak, u miratuan këto nivele të qirave, u bë shpallje në webfaqen e Bashkisë për të gjitha procedurat që duhen ndjekur për të aplikuar në programet e strehimit.
Në programin e subvencionimit të qirasë, qytetarët mund të përfitojnë subvencionim të plotë për qiranë e banesave që marrin me qira, ose subvencionim të pjesshëm.
Qiraja e subvencionuar varet nga numri i anëtarëve të familjes. Niveli më i lartë i qirasë është 26.000 lekë për familjet me shumë anëtarë , pesë ose gjashtë anëtarë dhe më pas, në varësi të numrit të anëtarëve të familjes, ulet edhe subvencionimi i qirasë. Kemi subvencionim të plotë për ata që nuk kanë asnjë të ardhur. Të ardhurat nga ndihma ekonomike dhe nga pagesat e pafisë nuk llogariten, nuk merren parasysh. Gjithashtu kemi edhe subvencionim të pjesshëm për qytetarët që kanë të ardhura nga punësimi, pensioni ose burime të tjera.
Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 18 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e pestë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin e listës emërore të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike që do të përfitojnë bursat financiare për vitin shkollor 2025-2026".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 5 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Ermir Hoxha : Projektakti u shqyrtua, u diskutua dhe u debatua gjithëpërfshirësisht, duke përfshirë edhe zëra nga opozita, në një mbledhje ku diskutimi plotësoi të gjitha kriteret etike dhe përmbajtësore për një trajtim të tillë. Tematika përfshinte bursat, një çështje shumë e ndjeshme sociale. Në këtë proces, u dëgjuan dhe autoritetet përkatëse dhe bashkia, të cilat dhanë shpjegime të hollësishme për mënyrën e administrimit dhe të përzgjedhjes. Projekti përfundimisht mori miratim të plotë, falë mirëmenaxhimit të kësaj hapësire ligjore që bën bashkia për trajtimin me bursa të nxënësve, ku u konstatua se plotësimi i kërkesave është 100% dhe nuk ka mbetur asnjë nga ato të paraqitura.

Këtu duam të theksojmë një pikë për dijeninë e prindërve dhe të nxënësve: ekziston një prioritet dhe një avantazh për nxënësit e shkollave profesionale, më konkretisht për shkollën profesionale që kemi ne. Kjo sepse ata marrin bursa direkt nga ministria përkatëse. Në këtë kontekst, bashkia bën një shpërndarje plotësuese të të gjitha kërkesave, duke marrë parasysh edhe këtë avantazh ekzistues për pjesën e shkollave profesionale.

Kjo gjë duhet shikuar me shumë interes nga prindërit, për të kuptuar se ku qëndron ndryshimi ndërmjet shkollës profesionale dhe shkollës së mesme klasike, siç e kemi në rastin konkret. Le të mos harrojmë se jetojmë në një vend ku tregu i punës ka nevojë të madhe për profesionistë.
Kjo pikë përfundimisht mori miratim dhe dakordësi të plotë pas shpjegimeve që u dhanë, dhe ne i ftojmë kolegët ta votojnë.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 18 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin e përdorimit dhe planin të shpërndarjes së fondit të grantit të bazuar në performancë të bashkive për vitin 2025 "

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 6 të rendit të ditës, kush ka pyetje nga ana e këshilltarëve?

Ermir Hoxha: Po,sërish në emër të Komisionit për Arsim dhe Sport, u shqyrtua ky fond. U shpjegua nga autoriteti përkatës i bashkisë, duke iu përgjigjur të gjitha pyetjeve dhe dyshimeve. Na u duk një shpërndarje logjike e fondit.

Megjithatë, një gjetje e veçantë ishte krijimi i një fondi të posaçëm për të ndihmuar elementin femëror ato gra që merren me artizanatin dhe që kanë nevojë të vazhdueshme për mbështetje në drejtime të ndryshme. Ky ishte një moment për t'u vlerësuar, ashtu siç ishin dhe pjesët e tjera: plani social, plani i arsimit dhe plani te tjera.
Kështu që, edhe kjo shpërndarje e fondit, pas pyetjeve, përgjigjeve dhe diskutimeve, gjeti dakordësi në nivel të komisionit. Bazuar në këtë qëndrim, i themi kolegëve: po, e miratojmë.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin

Miratohen me 18 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin e një ndryshimi në fushën e përdorimit të pasurisë 15/609 me sipërfaqe 9200 m^2 dhe pasurisë 15/610 me sipërfaqe 10810 m^2 zona kadastrale 8642 "truall" në pronësi të Bashkisë Sarandë , duke shtuar fushën e përdorimit për zhvillimin e programeve të arsimit parauniveristar dhe zhvillimin e projektit "poli i zhvillimit turistik sarandë".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 7 të rendit të ditës, kush ka pyetje nga ana e këshilltarëve?

Gjergji Imeraj : të na sqarojnë në mënyrë shteruese: pronën 15/609, prej 9200 m^2, si është sot, në çfarë gjendje është sot, a është ky investim që është bërë nga qeveria për kampus? Dhe të sqarojmë në mënyrë shteruese: pasurinë 15/610, me sipërfaqe 10810 m^2.
Zenel Bajrami : Atëherë nëse i referohemi projekt-vendimit që kemi sot përpara për diskutim, kemi të bëjmë në vijim të vendimit të këshillit bashkiak të miratuar më herët, disa muaj më herët, nuk i mbajmë të datën tani, për zbatimin e projektit të zhvillimit turistik të Sarandës. Si rrjedhojë

parauniversitar, flas për sipërfaqen 10800 m², pronë e bashkisë? Çfarë do të përfshihet në këtë sipërfaqe? Çfarë funksionesh nga poli i zhvillimit?
Së dyti, sa prej objekteve të polit të zhvillimit, që ka lidhje me pyetjen e parë, do të ndërtohen brenda sipërfaqes 10800 m²?
Edhe e treta, çfarë kompetencash ka Fondi Shqiptar i Zhvillimit mbi pjesën që është shtuar, është bashkangjitur sipërfaqes së pronësisë së bashkisë? Pra, ajo është me status juridik pronë shteti? Çfarë statusi ka Fondi i Zhvillimit mbi këtë? Çfarë kompetencash ka?

Martjon Zhupa: Në këtë sipërfaqe, objekti përfshin godinën multifunksionale. Pjesa e vilës qeveritare që është përsëri, është pjesë e ambientit të shërbimit që do të jetë për këtë strukturë. Është godina e akomodimit, edhe pishinat janë brenda, bashkohen bashkë me sipërfaqen që është shtesë. E keni edhe mbrapa projekt-vendimit gjithë pjesën .

Vesel Koçiu: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, çfarë kompetencash ka në lidhje me sipërfaqen që është pronë shteti atje?

Garufo Koka : Të drejtën e administrimit të kësaj sipërfaqeje i ka kaluar me vendimin e këshillit të ministrave. Jeni njohur gjatë miratimit .

Ibrahim Bajrami: cila është gjendja aktuale? Edhe tek pika dy, miratimin e shtesës së funksionit të përdorimit, a mundeni ta theksoni edhe njëherë? Të na e përcaktoni në mënyrë shteruese, siç e tha zoti Imeraj, çfarë ekzaktësisht bëhet në këtë hapësirë që është 1 hektar e pak? Ku ju thoni "funksione të tjera sipas ligjit"? Çfarë ekzaktësisht?

Garufo Koka : E kemi parë dhe nga materiali bashkëngjitur vendimit, bashkia e ka ndarë këtë pasuri në dy prona të ndara. Për të qenë dhe ju pak më të qartë, atëherë kemi sipërfaqen e parë 9200 m², mbi të cilën aktualisht është ndërtuar shkolla, për pjesën e dytë, do të vendoset në dispozicion të marrëveshjes së këtij investimi, të cilën ju e keni votuar në mbledhjen e muajit maj dhe që keni miratuar marrëveshjen e investimit. Konkretisht, objektet mbi të cilat do të ndërtohen i keni te masterplani, pasi iu tregua, të cilën ju jeni njohur dhe u citua edhe nga drejtori i projekteve.

Vesel Koçiu: E kam për drejtorinë e urbanistikës. Çfarë përfshihet në marrëveshje? Çfarë nënkupton marrëveshja? Regjistrimi i një pronësie 50% me 50% bashkë me Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Çfarë parashikon kjo 50%?

Garufo Koka : E keni të cituar, për sa i përket objekteve të cilat do të jenë pjesë e kësaj marrëveshje investimi, është neni 6 i cili parashikon se pas përfundimit të realizimit të objektit, i cili përfshin rikonstruksionin e vilës qeveritare, godinën e strukturës akomoduese, restorantin, qendrën multifunksionale, pishinën e jashtme dhe funksionet mbështetëse, do të regjistrohen pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në bashkëpronësi të bashkisë Sarandë dhe të Fondit Shqiptar të Zhvillimit në pjesë të barabartë. Edhe këtu dhe njëherë përforcohet fakti që pjesa e territorit të shkollës nuk është pjesë fare e kësaj marrëveshje bashkëinvestimi. Që do të thotë, në çdo marrëveshje bashkëinvestimi vendosin të dy në dispozicion asetet e caktuara dhe asetet që do të krijohen do të regjistrohen në bashkëpronësi në mënyrë të barabartë.

Vesel Koçiu: ky është vazhdim dhe zgjatim i projekt-vendimit që kemi kaluar më herët. Dhe këtu shtohen vetëm këto funksionet. Edhe herën e parë kam votuar, jam kundër këtij projekt-vendimi, sepse është bindja ime dhe unë s'mund të dal kundër bindjes time. Ndoshta mund të jem unë gabim, por nga këto që shikoj, mendoj se kështu do të jetë. Në radhë të parë, shkelja e parë dhe dyshimi i parë që shikoj unë, nuk është bërë fare dëgjes publik për një investim kaq madhor që parashikon edhe vetë marrëveshja që njësia e qeverisjes vendore është e detyruar të bëjë një konsultim publik. Së dyti, duke lexuar marrëveshjen nën për nenë, shikoj që Fondi Shqiptar i Zhvillimit është bashkëfinancues dhe përfitues me masën 50% me 50% të të ardhurave neto që krijohen nga fitimi. Pra, Fondi i Zhvillimit unë e shoh si një operator ekonomik fitimprurës që unë e di, ndaj sa njoh punë dhe sa njoh ligjin, është një institucion që mbështet projektet e zhvillimit pa fitim. Megjithatë, në qoftë se ka ndonjë klauzolë tjetër që unë nuk e njoh, unë nuk e njoh këtë punë. Së dyti, nga pyetjet që i drejtova punonjësve të administratës, u dha informacioni këtu që të gjitha ndërtimet e polit të tretë do të zhvillohen brenda territorit që është pronë e bashkisë Sarandë. Që do të thotë, kjo pronë do të merret prapë nga shteti nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit nëpërmjet një skeme të kamufluar. Këtu përfshihet edhe vila qeveritare, edhe ndërtimet që po bëhen. Komplet investimet do të bëhen në tokën e bashkisë. Pra, këtu kemi heqjen e një pjese që i është dhënë gabimisht, ndoshta sipas qeverisë së pushtetit vendor, dhe ndjekjen e planit të tyre për të privatizuar të gjitha vilat qeveritare me programe të kamufluara. Edhe fakti që menaxhimi i 50 viteve të para bëhet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe më pas do të gjykohet nga bashkëbisedimi me bashkëfinancuesin, me bashkinë Sarandë, por që mund t'i kalojë edhe një palë të tretë, tregojnë qartë se kemi të bëjmë me kalimin e shkallëzuar nga bashkia apo shteti tek privati, me kalimin e kohës. Prandaj, unë vazhdoj që ta votoj kundër.

Oltion Çaçi : Faleminderit. Po të jap një sqarim, se po, kryetar, nuk është, nuk qëndron ashtu siç ju po mundoni ta transmetoni këtu në publik, për sa kohë që qëllimi nuk është ashtu fare, sepse ne të gjithë jemi sot, ja dhe bashkitë në fund fare, në momentin që nuk kanë mundësi të investojnë, forma më e mirë është forma e bashkëpunimit. Në çdo rast, bashkëpunimi është brenda institucioneve shtetërore, nuk është institucion shtetëror dhe privat. E para. E dyta, qëllimi është për të ndërtuar, për të bërë teori dhe praktikë bashkë. E nuk kemi qëllim aty për të fituar, se nuk besoj sot që po vijnë oligarkët në Sarandë që të marrin një hotel me 48 dhoma dhe do mendojnë të fitojnë lekë. Nuk këtu, të gjithë janë, kam mbi 50 dhoma, këtu të gjithë që jemi flasim këtu dhe e kuptojnë që nuk ka nevojë të vijë një oligark për të marrë atë gjënë, por qëllimi është totalisht ndryshe. Aty është qëllim komplet edukativ. Ne po kërkojmë që këtë shkollën që është 9-vjeçare, ta kalojmë shkollë të mesme apo të lartë. Qëllimi është që universiteti të kalojë atje, shkolla ku u tha është universiteti të kthehet në shkollë 9-vjeçare, aty të bëhet dhe teoria dhe praktika bashkë. Kjo është e vërteta. Aty po i bëjmë dhe prandaj dhe i quajmë "Pol Zhvillimi", sepse po i bëjmë dhe teorinë dhe praktikën bashkë. Dhe kjo është pronë e bashkisë Sarandë. Për këtë jemi të qartë. Por juve doni ta lexoni ashtu,po ju kthehem publikisht, që nuk është e vërtetë. kryetar.

Ibrahim Bajrami: Procedurave administrative, vendimet tona e kanë pikën e detyrueshme që duhet të jenë të qarta. Megjithatë, dua të tërheq vëmendjen e këshillit tek pika dy. Bëmë disa herë pyetje mbi përdorimin e hapësirës e cila ka numrin 15/610. Edhe plani i zhvillimit që na keni dhënë më poshtë nuk i përkon kësaj hapësire. I përkon vetëm hapësirës së parë për pikën një. Për pikën dy, në asnjë moment nuk kemi asnjë plan të qartë. Më tepër sesa kaq, na thoni që i referoheni ligjit 8744, datë 22.2.2001. Unë e mora mundimin ta hapja këtë ligj. E kam edhe këtu

përpara meje, edhe i referohet pronave që i jepen bashkive njësive vendore. Në veçanti, thotë pika "a": për të kryer ushtrimin e funksioneve të tyre administrative. Bëjnë programe arsimore. Në funksione të shëndetit publik mund të ishte një gjë, funksione ekonomike, veprimtari social-kulturore, sportive, thotë pika "d". Tek "e" kemi depozitim, pastrim, shfrytëzim të plehrave, gjëra të tilla, transport publik në pikën "ë". Tek pika "gj", varreza thotë, vazhdojnë të numërohen këtu. Nuk do t'i numëroj të gjitha. Këtu: objekte historike kulturore, mund të kemi muzeume, gjëra të tilla. Parqe, kullota, s'kemi gjëra të tilla. Janë te pika "i". Megjithatë, ju shkoni te pika "i" thotë: struktura dhe njësi rezidenciale me interes vendor.As kjo nuk është. Ju shkoni dhe përqëndroheni te pika "k": "Prona të cilat përdoren për kryerjen e funksioneve të tjera sipas ligjeve në fuqi." Të gjitha ligjet në fuqi. Central atomik, termocentral. Të gjitha ligjet shqiptare e kanë atë mundësi. Ne mund të kemi çfarëdo lloj gjëje këtu. Një pus nafte. Praktikisht, sipas kësaj pike, ne mund të kemi pus nafte nesër këtu. Ju shkoni dhe thoni: "Prona të cilat përdoren për kryerjen e funksioneve të tjera dhe ju lutem sipas ligjeve në fuqi."Dhe unë nuk kam folur asgjë nga xhepi. Aktualisht isha te ligji. Zoti Imeri pyeti dhe kërkoi që të sqarohet në mënyrë shteruese se çfarë do të bëhej me pikën dy, siç bëri dhe me pikën një. U çuan këtu përfaqësuesit dhe na thanë se çfarë do të bëhej me pikën një.Pika dy akoma nuk e dimë se çfarë ekzakte.

Ilir Gërdhuqi: atëherë siç e theksoi edhe drejtori i urbanistikës, të gjitha këto diskutime duhet të ishin bërë kur u miratua plani në tërësi. Dhe këto normalisht janë si rrjedhojë e miratimit të atij plani. Sigurisht janë hapa juridikë që duhet të ndërmerren, por unë e mora fjalën për një bashkangjitje fjalës së kolegëve, se këto shqetësime janë ngritur dhe andej, pavarësisht se mori shumicën këtu në këshill, ai projekt-vendim, domethënë ai plan. Unë personalisht që atëherë jam shprehur kundër atij projekti, për arsye se në pjesën më të madhe të tij kam menduar që është kundër interesave të qytetarëve. Kështu që, duke dashur të pozicionohem dhe sot, do jem kundër këtij projekt-vendimi dhe çdo projekt-vendimi që ka lidhje me atë projekt. Faleminderit.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin

Miratohen me 13 vota pro, abstenim 1, kundër 4.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e tetë të rendit të ditës

Informacion mbi transferimin e komunitetit romë nga ambjentet e ish kinemasë së Çukës.

Ibrahim Bajrami : Kemi një komunitet të vogël diku te gjashtë familjet zakonisht që banojnë në ambientet e ish-Kinemasë, ose asaj ndërtese që u projektua për të qenë kinemaja e fshatit Çukë dhe asnjëherë nuk u realizua. Ajo ndërtesë ngeli e pandërtuar, pa e përfunduar. Në ambientet e saj u strehuan, si në shumë ambiente të tjera të pronësisë së shtetit, një numër familjesh, familje rome kësaj radhe. Banojnë aty prej më shumë se 30 vitesh. Ajo ndërtesë ka qenë e pasigurt prej shumë kohësh. E dimë këtë çështje. Unë vetë e kam ngritur këtë pikë shumë vite përpara edhe këtu. Nuk është marrë ndonjë masë. Tashmë ju ka shkuar atyre vendimi që të dalin përjashtë, sepse ndërtesa është e pasigurt. Nuk kemi asnjë plan të qartë se ku do t'i çojmë. Diskutohet që mundemi t'i çojmë në fushën e Palit, në një vend me lagështirë, ku realisht nuk banon njeri, tre çerek ore larg me këmbë nga çdo lloj zone tjetër e banuar.

Joli Dine : Tema që ndriti këshilltari Bajrami ka qenë në vëmendjen tonë maksimale që nga fillimi i këtij problemi, me porosi të veçantë të kryetarit të bashkisë. Është ngritur një grup pune i

përbërë nga disa institucione. Të cilët kemi, gjatë gjithë kësaj jave kemi kërkuar vende ku mund të çoheshin këta banorë me qëllim që të kishin kushtet optimale për jetesë. Është e vërtetë që ne kemi gjetur një magazinë në fshatin Pal, ku mund të strehohen. Nuk është zyrtare vendimi për të strehuar këta banorë në këtë magazinë, por është një çështje që ne, për shkak të emergjencës që kemi, e kemi gjetur si zgjidhje tranzitore, me qëllim që të kemi dhe ne mundësi që të gjejmë banesa të tjera që mund t'i strehojmë këta banorë. Sepse me emergjencë është heqja e tyre atje dhe pastaj dhe sistemimi i tyre në kushte që mund të jenë të favorshme për ta. Është e vërtetë që mund të jetë pak larg punës, por do të ketë gjithë përpjekjen e mundshme nga gjithë drejtoritë e bashkisë Sarandë që të krijojnë kushtet e nevojshme si për jetesën, ashtu edhe për pjesën e aksesit që mund të kenë me qytetin dhe me punët e tyre.

Ibrahim Bajrami : Ju keni gjetur një magazinë. Të gjitha ato magazina, përpara, jo shumë larg, kanë qenë të përmbyllura. Uji shkoi në fushën e Palit mbi 40 cm në momentin që u hap argjinatura. Ju e dini shumë mirë, jeni marrë me argjinaturën personalisht, me sa mbaj mend. Këta njerëz e kanë treguar që kanë mundësinë të ndryshojnë, kanë mundësinë të jenë më mirë. Në qoftë se ne i çojmë 45 minuta me këmbë larg nga Saranda, pa asnjë automjet për të ardhur në Sarandë, asnjë mundësi. Le të marrë vendim këshilli i bashkiak i Sarandës, këtë ambient, ambientin e ish-Kinemasë, apo diskutojmë që do të prishë. Këtë ambient, këtë hapësirë, këtë tokë që këta njerëz e kanë banuar dhe kanë pasur të drejtë gjithë kohën ta privatizonin. Nuk e kanë privatizuar vetëm se s'dinë të shkruajnë dhe të lexojnë. Ka dhe intelektualë që kanë shkuar në universitet, puna është të ndihmojmë këta. Gjashtë familje, të lutem, këtë vend që ata kanë të drejtën me ligj, ta privatizonin. A nuk mundemi ne të marrim një vendim?

Asaf Stroka: Zoti Bajram, të falënderoj shumë dhe të kam falënderuar edhe për sa i përket diskutimit të kësaj pike në këtë rend dite. Për sa i përket problematikës që ju diskutuat, e mori, e ka marrë zgjidhjen nga ekzekutivi. Për sa i përket propozimit tuaj, ne si këshill bashkiak e marrim në shqyrtim dy komisione të përbëra: Komisioni Juridik, Komisioni i Ekonomik . Propozimi bërë nga ana juaj, të jeni dhe udhëheqës i komisionit, të bëjmë një propozim për sa i përket kësaj ndërtese, se ne nuk mund të diskutojmë sot një përgjigje, një objekt, e cila nuk kemi informacion, nuk kemi dhe informacionin e duhur në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës. Propozojmë të jetë pikë në mbledhjen e ardhshme, të mblidhen komisionet, të hartohet një projekt-vendim në qoftë se nuk vjen nga ekzekutivi.

Asaf Stroka: Ju faleminderit. Unë insistoj pavarësisht se zoti Bajrami tërheq vërejtje në lidhje me këtë pikë. Nuk mund të diskutojmë ne konkretisht Për sa i përket propozimeve të bëra nga zoti Bajrami dhe zoti Ahmeti, në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, e ftoj dhe zotin Bajrami të bëhet pjesë e komisioneve, të marrin personat që ngarkon ligji, që do japin gjithë anën teknike lidhur me propozimet që do bëhen nga këshilli bashkiak, apo pse jo, edhe nga ekzekutivi, për t'u ardhur në ndihmë këtij komuniteti.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës

Informacion mbi raportin e performancës së Bashkisë Sarandë për vitin 2025.

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 9 të rendit të ditës, kush ka pyetje nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka : Duke ju falenderuar , e deklaroj mbledhjen të mbyllur.

Ky proçesverbal mbyllet me nr.rendor 11 (njëmbëdhjetë) fletë, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe komisioni i verifikimit të procesverbalit.

Mbajtësi i proçesverbalit: Valbona Vasili

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

1.	Kryetar i Këshillit Bashkiak :	Asaf Stroka
2.	Partia Socialiste e Shqipërisë:	Lindita Kondi
3.	Partia,Drejtësi,Integrim dhe Unitet:	Klejdjan Murtaj
4.	Partia Balli Kombëtar:	Bejdo Çela
5.	Partia Republikane Shqiptare :	Përparim Ahmeti
6.	Fryma e Re Demokratike:	Ilir Gërdhuqi
7.	Kryetar i Grupit Bashkë Fitojmë:	Shpëtim Ahmeti
8.	Kryetar i Grupit Partia Demokratike:	Vesel Koçiu
9.	Aleanca Arbnore Kombëtare:	Xhino Jaçaj
10.	I pavarur	Kevin Alikaj